



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PROTIV KORRUPCIE
ANTI-CORRUPTION AGENCY


Udhë:
Drejtoria:
Drejtoria:
Nr. i aktit:
Drejtoria:
Nr. i aktit:

DPK

Nr. Prot:
Bil. Prot:
Prot. No:
Data:
Datum:
Data:

03-02/4021/17

07.12.2017



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 05.12.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2539/17, për zyrtarin e lartë z. Fidan Ademi, Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Mitrovicës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik .

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-2539/17, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Fidan Ademi, Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Mitrovicës.

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, është vërejtur se zyrtari i lartë z. Fidan Ademi, figuron si person i autorizuar në bizneset private me emër "Demastioni" SH.P.K, dhe "Pestel Consulting" SH.P.K, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë njoftuese se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Ademi, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe është interesuar për një takim me zyrtarët e AKK-së për tu njoftuar për situatën që është duke u trajtuar.

Ne takimin e organizuar në zyrat e AKK-së me zyrtarin z.Fidan Ademi, zyrtarët e AKK-së, e kanë njoftuar zyrtarin e lartë me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin e iniciuar.

z.Ademi, është pajtuar me gjendjen, por është arsyetuar nuk ka qen i informuar se kjo situatë është në kundërshtim me ligjin në fuqi si dhe ka deklaruar se do të veproj sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit duke sjell dëshmi se nuk do të figuroj si person i autorizuar ne biznese private.

Pas këtyre veprimeve, nga z.Fidan Ademi, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se zyrtari i lartë z. Fidan Ademi, nuk figuron me si person i autorizuar ne bizneset e tij private me emër "Demastioni"SH.P.K dhe "Pestel Consulting" SH.P.K- me.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga z.Fidan Ademi, Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Mitrovicës, duke bërë ndryshimet ne biznes, duke hequr dorë nga përgjegjësit dhe të drejtat e funksionit si personi i autorizuar ne bizneset e tij private janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendja e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë,dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

